



Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/L-038, neni 14, dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 17 dhe 30, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 30 qershor 2022, nxori këtë

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE SHKENCORE

Neni 1

1. Rregullorja përcakton mënyrën e realizimit të aktiviteteve shkencore në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në tekstin e mëtejme Akademia);
2. Aktivitete shkencore konsiderohen: projektet shkencore, botimet shkencore, tubimet shkencore, ligjëratat dhe promovimet;
 - 2.1. Aktivitetet që lidhen me projekte dhe botime shkencore të Akademisë rregullohen me rregullore të veçanta;
3. Tubimet shkencore janë ngjarje sociale ku mblidhen shkencëtarët dhe ekspertët e një lëmie të caktuar, për një periudhë një ose disaditore, për prezantimin e të arriturave të tyre dhe vlerësimin kritik nga komuniteti shkencor;
4. Qëllimi kryesor i një tubimi shkencor është shqyrtimi i një problematike shkencore me një pjesëmarrje të një numri të caktuar të shkencëtareve dhe të ekspertëve të fushës me mundësinë që ata të shkëmbejnë mendime dhe informacione;
5. Organizimi i tubimeve shkencore bëhet me pjesëmarrje fizike dhe online, ose të kombinuar;
6. Tubimet shkencore mund të jenë të formatit të ndryshëm: kongrese, konferenca, simpoziume, tryeza shkencore dhe seminare.

Neni 2

1. Kongreset shkencore

- 1.1. Kongreset shkencore janë tubime të përmasave të gjëra në kuadër të një fushe, në të cilët marrin pjesë më shumë se 100 pjesëmarrës, të nivelit kombëtar ose ndërkombëtar;
- 1.2. Kongreset mbahen në formë të ligjëratave plenare dhe të ligjëratave tematike, të cilat përfshijnë aspekte të ndryshme të temës kryesore të kongresit;
- 1.3. Në kongrese ftohen ekspertë të njohur për ligjërata tematike ose plenare;
- 1.4. Në kuadër të kongreseve mund të organizohen ngjarje kulturore dhe takime profesionale;
- 1.5. Kongreset zgjasin 2-4 ditë;
- 1.6. Kongreset kanë këshillat organizative shkencore;
- 1.7. Pjesëmarrësit e ftuar për ligjërata plenare ose tematike i dorëzojnë paraprakisht abstraktet e punimeve, të cilat përzgjidhen nga këshilli shkencor i kongresit;
- 1.8. Kumtesat dhe ligjëratat e kongreseve publikohen në botim të veçantë.

Neni 3

1. Konferencat shkencore

- 1.1. Konferencat shkencore janë tubime të organizuara nga Akademia ose në bashkëpunim me institucione të ndryshme shkencore;
- 1.2. Konferencat shkencore mbahen me pjesëmarrje më të gjerë, ose për një temë të caktuar, me pjesëmarrje më të ngushtë;
- 1.3. Konferencat shkencore i zhvillojnë punimet në formë të ligjëratave plenare, ligjëratave tematike, të prezantimeve me gojë dhe posterëve të pjesëmarrësve në konferencë;
- 1.4. Në konferenca shkencore marrin pjesë shkencëtarë, ekspertë dhe shkencëtarë të rinj të fushave përkatëse;
- 1.5. Konferencat shkencore kanë këshillat organizative shkencore;
- 1.6. Pjesëmarrësit në konferencat shkencore i dorëzojnë abstraktet e tyre për prezantim, ndërsa përzgjedhjen e tyre e bën këshilli organizativ shkencor i konferencës;
- 1.7. Konferencat shkencore prihen nga ligjërata tematike dhe plenare, të cilat mbahen nga shkencëtarë me të arritura të rëndësishme;
- 1.8. Kumtesat e konferencave shkencore publikohen në një botim të veçantë, ose në revistën shkencore të seksionit përkatës.

Neni 4

1. Simpoziumet shkencore

- 1.1. Simpoziumet shkencore janë tubime me pjesëmarrje më të vogël, në të cilët marrin pjesë ekspertët e fushave të caktuara;
- 1.2. Në simpoziume ekspertët e fushës paraqesin rezultatet dhe opinionet e tyre në kuadër të temës, e cila shqyrtohet;
- 1.3. Simpoziumet kanë këshillat organizative shkencore;
- 1.4. Në simpoziume ftohen ekspertë të njohur për ligjërata tematike;
- 1.5. Pjesëmarrësit e ftuar i dorëzojnë paraprakisht abstraktet e punimeve, të cilat përzgjidhen nga këshilli organizativ shkencor i simpoziumit;
- 1.6. Kumtesat e simpoziumeve publikohen në një botim të veçantë, ose në revistën shkencore të seksionit përkatës.

Neni 5

1. Tryezat shkencore

- 1.1. Tryezat shkencore janë tubime me pjesëmarrje më të ngushtë, që trajtojnë një temë nga fushat përkatëse;
- 1.2. Tryezat shkencore organizohen në formën e prezantimeve, udhëhiqen nga një moderator, ndërsa pjesëmarrësit paraqesin rezultatet shkencore dhe mendimet e tyre;
- 1.3. Tryezat shkencore kanë këshillat organizative shkencore;
- 1.4. Kumtesat e tryezave shkencore publikohen në revistën shkencore të seksionit përkatës.

Neni 6

1. Ligjëratat shkencore

- 1.1. Ligjëratat shkencore janë prezantime individuale profesionale të anëtarëve të Akademisë, të anëtarëve të jashtëm dhe të shkencëtarëve të shquar vendës dhe të huaj;
- 1.2. Propozimin për mbajtjen e ligjëratave e paraqet seksioni përkatës dhe e miraton Kryesia e Akademisë.

Neni 7

1. Promovimet e botimeve

- 1.1. Akademia organizon promovimin e botimeve të veta;
- 1.2. Propozimin për promovimin e botimit ia paraqet Kryesisë seksioni përkatës, pas miratimit nga autorët;
- 1.3. Prezantimin hyrës të botimit e bën sekretari i seksionit;
- 1.4. Prezantimin e përmbajtjes dhe të vlerësimit të botimit e bëjnë recensentët ose ndonjë njohës i fushës i caktuar nga seksioni;
- 1.5. Me rastin e promovimit, një numër kopjesh të botimit jepen falas.

Neni 8

1. Anëtarët e Akademisë e paraqesin propozimin për organizimin e aktiviteteve shkencore në seksionin përkatës;
2. Propozimi përmban: emërtimin, temën dhe llojin e aktivitetit shkencor; numrin e pjesëmarrësve, karakterin lokal apo ndërkombëtar të aktivitetit, këshillin organizativ, gjuhën që përdoret, llojin e përkthimit dhe përlllogaritjen e shpenzimeve;
3. Propozimi miratohet në seksion, shqyrtohet nga Kryesia e Akademisë dhe miratohet përfundimisht nga Kuvendi i Akademisë;
4. Propozimi i miratuar nga Kuvendi i Akademisë bëhet pjesë e programit të punës së saj për vitin përkatës.

Neni 9

1. Propozime për organizimin e aktiviteteve shkencore paraqet edhe Kryesia e Akademisë;
2. Anëtarët e Kryesisë mund të propozojnë organizimin e aktiviteteve shkencore edhe jashtë programit vjetor të punës së Akademisë;
3. Propozimi sipas paragrafit 2.1. shqyrtohet dhe miratohet në mbledhje të rregullt të Kryesisë.

Neni 10

1. Seksionet në mbledhje të rregullta, me vendim caktojnë këshillat organizative shkencore në përbërje prej: kryesuesit, sekretarit dhe anëtarëve;
2. Bartës të aktiviteteve shkencore, përfshirë kryesuesin dhe sekretarin e këshillit organizativ, janë anëtarët e Akademisë;

3. Anëtarë të këshillave organizative shkencore mund të jenë edhe ekspertë të shquar kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
4. Këshillat organizative shkencore të gjitha punët për organizimin e aktivitetit i bashkërendojnë me sekretarët e seksioneve.

Neni 11

1. Detyrat e këshillave organizative shkencore: hartojnë kornizën përmbajtjesore të aktivitetit shkencor; propozojnë kohën e mbajtjes, numrin e pjesëmarrësve, të ftuarit e veçantë; përcaktojnë listën e të interesuarve për aktivitetin shkencor, shqyrtojnë, vlerësojnë dhe përzgjedhin punimet e pjesëmarrësve, përgatisin shpalljen zyrtare për organizimin e aktivitetit shkencor, si dhe hartojnë programin përfundimtar të aktivitetit shkencor;
2. Pas përfundimit të aktivitetit shkencor, këshilli organizativ shkencor përgatit tekstet për botim;
3. Këshilli organizativ nuk kompensohet;
4. Pas botimit të teksteve të tubimeve shkencore, kryesuesi dhe anëtarët e këshillit organizativ kompensohen sipas Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të Akademisë, neni 5, paragrafi 6.

Neni 12

1. Pjesëmarrësve në aktivitete shkencore nga jashtë Kosovës iu mbulohen shpenzimet e akomodimit dhe në raste të caktuara edhe të qëndrimit;
2. Në rastet kur aktivitetet shkencore janë njëditore, shpenzimet e akomodimit mbulohen për dy net, ndërsa kur aktivitetet shkencore janë dyditore shpenzimet e akomodimit mbulohen për tri net;
3. Për kongreset dhe tubimet shkencore të jashtëzakonshme, kohëzgjatja e akomodimit caktohet me vendim të Kryesisë;
4. Të ftuarve të veçantë të aktiviteteve shkencore iu mbulohen edhe shpenzimet e udhëtimit, jo më shumë se 3 veta;
5. Autorët e punimeve të publikuara në botimin përkatës paguhen sipas Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të Akademisë.

Neni 13

1. Rezultatet e aktiviteteve shkencore botohen në gjuhën shqipe, ndërsa me propozim të këshillit organizues mund të botohen edhe në gjuhë të tjera me aprovim të Kryesisë së ASHAK-ut.

Neni 14

1. Rregullorja hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Krasa

